

UDHËZIM
Nr. 421, datë 19.7.2022

**PËR MBËSHTETJEN NËPËRMJET KOMPENSIMIT FINANCIAR PËR MJEKËT
SPECIALISTË TË EMËRUAR LARG VENDBANIMIT TË TYRE PËR NJË
PERIUDHË 3-VJEÇARE, NË BAZË TË DETYRIMIT KONTRAKTOR ME
MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR ÇËSHTJET E SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 11/1, e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 11.8.2011, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, në strukturat e tjera të forcave të armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Mjekët, pas përfundimit të specializimit në spitalet universitare, në bazë të detyrimit kontraktor me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale emërohen sipas nevojave të sistemit shëndetësor për një periudhë trevjeçare.

2. Mjekët e përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi, të cilët emërohen larg vendbanimit të tyre përfitojnë një kompensim në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

3. Mjekët e përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi duhet të vërtetojnë që ushtrojnë detyrën larg vendbanimit të tyre, duke depozituar pranë institucionit shëndetësor ku janë emëruar një vërtetim banimi nga institucionet kompetente sipas ligjit.

4. Mjekët e përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi, të cilët janë emëruar dhe kanë filluar detyrën para datës 1 korrik 2022 do të jenë përfitues të kompensimit për kosto jetese për pjesën e mbetur të kohëzgjatjes së kontratës 3-vjeçare.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore dhe drejtoritë rajonale të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, si dhe institucionet shëndetësore publike për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu